



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.25/ 6 prot.

Datë 01.02.2024

V E N D I M
Nr. 124/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.02.2024 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-88148-11-17-2023, me objekt “Blerje Kompjuterë dhe Projektor”, me fond limit: 2,054,475.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.01.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastër.
- Ankimues:** “Blueprint Technologies” SHPK me NIPT L82428011G dhe adresë: Njësia Administrative nr. 10, Rruga “Fortuzi”, Nr.66/1, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastër, me adresë: Lagjja “18 Shtatori” Gjirokastër.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.11.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-88148-11-17-2023, me objekt “Blerje Kompjuterë dhe Projektor”, me fond limit: 2,054,475.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.01.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastrë.

II.2. Në datën 03.01.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 03.01.2024, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “BluePrint Technologies” SHPK	955,000 leke	skualifikuar
2. Euro Inform” SHPK	1,027,800 leke	skualifikuar
3. ”PC Store” SHPK	1,185,000 leke	kualifikuar

4. "SEELLSS" SHPK	1,500,000 leke	kualifikuar
5. "MIFEEL" SHPK	1,540,858 leke	kualifikuar
6. "Electron Albania 2008" SHPK	1,572,500 leke	kualifikuar
7. Sofia Myftari	1,689,000 leke	kualifikuar
4. "GE-D" SHPK	1,790,000 leke	skualifikuar

II.4. Në datën 05.01.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike njoftimi i fituesit paraprak.

II.4.1. Operatori ekonomik ankimes rezultatit skualifikuar për arsye se:

"OE ka paraqitur oferte anomalisht të ulët. Justifikimi i paraqitur nuk argumenton çmimin."

II.5. Në datën 05.01.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/3734 dhe me nr. 25/2024 prot., datë 08.01.2024 e operatorit ekonomik "Blueprint Technologies" SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt-ankimi duke argumentuar: *"OE Blueprint Technologies ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit me reference REF-88148-11-17-2023*

Me datë 19.12.2023 nëpërmjet SPE kemi marrë kërkesën për argumentim të ofertes, pasi sipas formulës oferta jone rezultonte anomalisht e ulët.

Me datë 19.12.2023 nëpërmjet SPE kemi kthyer përgjigje, me argumentet tona në lidhje me ofertën.

Me datë 03.01.2024 kemi marrë njoftimin e skualifikimit në SPE, me argumentin se:

Justifikimi i paraqitur nuk argumenton çmimin.

Vleresojmë se skualifikimi nuk është bërë në përputhje me LPP dhe VKM për RPP pasi në argumentimin e ofertes, kemi dhënë shpjegime në përputhje me nenin 93 të LPP, konkretisht:
a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit:

Në argumentimin e ofertes, kemi paraqitur fakte që vlera e fondit limit nuk pasqyron çmimin e tregut. Konkretisht nëpërmjet një linku të prodhuesit HP

[https://www.hp.com/gb-en/shop/product.aspx?id=6UAS0EA &opt=ABU&sel=DTP](https://www.hp.com/gb-en/shop/product.aspx?id=6UAS0EA&opt=ABU&sel=DTP)

kemi vërtetuar se çmimi me pakicë 1 një kompjuteri desktop është 7587 ose 69800 leke me tvsh, ndërkohë që kemi ofertuar 72.000 leke me tvsh.

Çmimi i mesiperm (69800 leke) i mesiperm, është çmimi pakicë, për 1 copë, i blerë jo në kanale distribucioni por në treg të lirë.

Qartësisht, çmimet që në si OE marrim tek Furnitoret tane, që janë distributor të Autorizuar të HP, është mbi 30% më i ulët se ai i pakicës.

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

Kushte favorizuese për procedurën në fjalë, sic edhe e kemi shpjeguar në përgjigjen tonë, është blerja direkt në Distributore të Autorizuar si dhe kursi i favorshëm i këmbimit GBP/ALL (Furnitoret tane ndodhen në Angli), çka e bën ofertën tonë me konkurrense se OE

qe kane patur mallin stok. Sipas katalogut te ngarkuar ne Sistem se bashku me oferten, oferta bazohet ne produkte origjinale HP. Ne pergjigjen tone, kemi rikonfirmuar se oferta bazohet ne produkte origjinale.

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës:

I certifikuar me ISO 9001, 27001 dhe 14001 , veprimtaria e OE Blueprint Technologies eshte totalisht ne perputhje me detyrimet qe rrjedhin nga legjislacioni ne fushen e mjedisit, sociale dhe te punes.

Se fundmi deshirojme te theksojme se oferta jone rezulton anomalisht e ulet, per shkak te ofertave te tjera qe nuk pasqyrojne cmimin e tregut (sic eshte treguar me linkun e HP) , por qe jane oferta abuzive, sic ne konsiderojme cdo oferte mbi 1.500.000 leke ne kete prokurim, Qellimi i LPP eshte te prokuroje me cmimim me te ulet brenda specifikimeve teknike. Nga dokumentacioni i paraqitur, AK ka te gjithë informacionin e duhur per te vleresuar se specifikimet teknike te pajisjeve te ofertuara jane ne perputhje te plote me kerkesat e tyre.

Per sa me siper kerkojme nga ana juaj kualifikimin e oferte, si nje oferte e vlefshme, ne perputhje me LPP.”

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit 25/2, datë 09.01.2024, u publikuan arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues.

II.7. Referuar sistemit të ankesave elektronike rezulton, se në seksionin “Kërkesa” në SPE, autoriteti kontraktor më datë 19.12.2023, i ka kërkuar shpjegim për ofertën anomalisht të ulët operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK.

II.8. Në përgjigje të kërkesës më sipër të autoritetit kontraktor përmes sistemit të ankesave elektronike, operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, më datë 19.12.2023, ka kthyer përgjigje duke argumentuar ofertën anomalisht të ulët si më poshtë vijon:

Lenda: Kthim pergjigje: Argumentim Oferte anomalisht e Ulet

Drejtuar: Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokaster

Ne pergjigje te kerkeses tuaj ne SPE date 19.12.2023 , deshirojme tju argumentojme se:

- 1- Oferta jone bazohet ne paisje te reja, origjinale dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara nga ana juaj, sipas katalogjeve te ngarkuar ne SPE.
- 2- Oferta jone pasqyron cmimet qe ne marrim nga furnitori jone, i cili eshte distributor i Autorizuar i HP, duke aplikuar marxhin tone te fitimit, i cili ne rastin e prokurimeve publike eshte i ulet , duke patur parasysh natyren e prokurimit si dhe konkurrencen ne keto procedura.
- 3- Cmimet me te cilat ju keni llogaritur fondin limit, referuar tabelave te AKSH-it nuk pasqyrojne vleren e tregut, pasi jane llogaritur 2 vjet para, nderkohe qe produktet e teknologjise se informacionit permiresohen shume shpejt, dhe ajo cka kushtonte 131.472 leke pa tvsh para 2 vitesh, sot eshte shume me e lire (Referuar vleres se AKSHI-T per Desktop 1)
Konkretisht linku i HP per cmimet me pakice
<https://www.hp.com/gb-en/shop/product.aspx?id=6U450EA&opt=ABU&sel=DTP>
- 4- OE Blueprint Technologies, blen direkt nga prodhuesit ose distributor te autorizuar te tyre, duke bere te mundur blerje me kosto me te ulet, gje qe reflekton dhe oferten me cmime me te mira.
- 5- OE Blueprint Technologies, ne procedura te caktuara, per te arritur objektivin e volumit blerjeve vjetore tek furnoret, aplikon norma me te ulta fitimi per disa nga projektet.
- 6- Duke qene produkte importi, kursi aktual i GBP/ALL 120:1 , favorizon cmime me te uleta se operatoret qe mund ti kene produktet stok nga periudha kur Kursi ka qene 20% -30 % me i larte, cka automatikisht rrit koston e tyre me 20-30%
- 7- Veprimtaria e OE Blueprint Technologies eshte teresisht ne perputhje me detyrimet qe rrjedhin nga legjislacioni ne fushen e mjedisit. Per me teper Blueprint Technologies eshte i certifikuar ISO 14001, ISO 9001 dhe ISO 27001

II.9. Me shkresën nr.63/3 prot., datë 12.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 25/3 prot., datë 19.01.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues me argumentin se:

“Ne si komision gjykojmë:

OE “Blueprint Technologies” nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion justifikues lidhur em çmimin e ofertuar si p.sh.: faturë blerje, shpjegime të detajuara të ofertës ekonomike, anën ekonomike të mallrave të ofruara ose dokument justifikues për blerjen e zërave të kërkuar direkt nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për të vërtetuar mundësinë e blerjes me kosto të ulët gjithashtu referuar vlerës së AKSHI-it për kompjuter Desktop 1 dhe Projektor Tipi 1, konstatojam se: çmimet janë me vlerë më të vogël se çmimet e tregut për vitin 2022-2023.”

II.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk ka argumente të dorëzuar nga subjekte të interesuara në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” SHPK mbi skualifikimin e ofertës së tij, me argumentin se: *“OE ka paraqitur ofertë anomalisht të ulët. Justifikimi i paraqitur nuk argumenton çmimin.”* KPP vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me nr. 63/3 prot., datë 12.01.2023, e protokolluar me tonën me nr. 25/3 prot., datë 19.01.2023, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton, se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët. Në këto kushte KVO, më datë 19.12.2023, nëpërmjet SPE, i është drejtuar operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, me kërkesën që brenda tre ditëve të japë shpjegime për çmimin dhe kostot e propozuara në ofertë.

III.1.2. Referuar dokumentacionit të administruar nga autoriteti kontraktor, por edhe verifikimeve të kryera në SPE rezulton, se në përgjigje të kërkesës së autoritetit kontraktor, operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, më datë 19.12.2023, ka paraqitur argumentimin me qëllim justifikimin e ofertës anomalisht të ulët si më poshtë:

Lenda: Kthim pergjigje: Argumentim Oferte anomalisht e Ulet

Drejtuar: Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokaster

Ne pergjigje te kerkeses tuaj ne SPE date 19.12.2023 , deshirojme tju argumentojme se:

- 1- Oferta jone bazohet ne paisje te reja, origjinale dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara nga ana juaj, sipas katalogjeve te ngarkuar ne SPE.
- 2- Oferta jone pasqyron cmimet qe ne marrim nga furnitori jone, I cili eshte distributor I Autorizuar I HP, duke aplikuar marzhin tone te fitimit, I cili ne rastin e prokurimeve publike eshte I ulet , duke patur parasysh natyren e prokurimit si dhe konkurencen ne keto procedura.
- 3- Cmimet me te cilat ju keni llogaritur fondin limit, referuar tabelave te AKSH-it nuk pasqyrojne vleren e tregut, pasi jane llogaritur 2 vjet para, nderkohe qe produktet e teknologjise se informacionit permiresohen shume shpejt, dhe ajo cka kushtonte 131.472 leke pa tvsh para 2 vitesh, sot eshte shume me e lire (Referuar vleres se AKSHI-T per Desktop 1)
Konkretisht linku I HP per cmimet me pakice
<https://www.hp.com/gb-en/shop/product.aspx?id=6U450EA&opt=ABU&set=DTP>
- 4- OE Blueprint Technologies, bien direkt nga prodhuesit ose distributor te autorizuar te tyre, duke bere te mundur blerje me kosto me te ulet, gjë qe reflekton dhe oferten me cmime me te mira.
- 5- OE Blueprint Technologies, ne procedura te caktuara, per te arritur objektivin e volumit blerjeve vjetore tek furnitorët, aplikon norma me te ulta fitimi per disa nga projektet.
- 6- Duke qene produkte importi, kursi aktual I GBP/ALL 120:1 , favorizon cmime me te uleta se operatorët qe mund ti kene produktet stok nga periudha kur Kursi ka qene 20% -30 % me I larte, cka automatikisht rrit koston e tyre me 20-30%
- 7- Veprimtaria e OE Blueprint Technologies eshte teresisht ne perputhje me detyrimet qe rrjedhin nga legjislacioni ne fushen e mjedisit. Per me teper Blueprint Technologies eshte I certifikuar ISO 14001, ISO 9001 dhe ISO 27001

III.1.3. Në nenin 93, pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet se: “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose koston e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [....]”

III.1.4. Në nenin 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*
- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.*
- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.*

III.1.5. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se oferta ekonomike në vlerën prej 955,000 lekë pa TVSH, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP gjykon, se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët, njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu, është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë *mundësinë* e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93, pika 3 të LPP-së, autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. KPP gjykon, se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP thekson se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; *“Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”*. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërimit të operatorit ekonomik ankimes, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93, pika 2 i LPP-së, si dhe *mundësinë* për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.1.6 Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe

rregullat e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues, argumentimin e ofertës në mënyrë narrative përmes shkresës së ngarkuar në SPE më datë 19.12.2023, por nuk ka paraqitur analizë kostoje të detajuar, që të argumentojë kushtet apo elementet, se pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, ka paraqitur argumentimin e tij në formën e një sqarimi narrativ, i cili nuk përbën element të mjaftueshëm provues për justifikimin e ofertës anomalisht të ulët. Në këtë kuptim KPP gjykon, se shpjegimi narrativ përmes shkresës së datës 19.12.2023 të paraqitur në SPE, nuk është i mjaftueshëm për autoritetin kontraktor, për të krijuar bindjen, se ankimuesi do të sigurojë realizimin me sukses të kontratës. Operatori ekonomik ka dështuar të provojë me dokumentacion mbështetës argumentimin e ofertës anomalisht të ulët dhe pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët krijon bindjen për përmbushjen me sukses të kontratës. Ankimuesi ka detyrimin ligjor, që të prezantojë me dokumentacion provues katër kushtet kumulative të përcaktuara në nenin 93, pika 2, të lex specialis, si dhe *mundësinë* (në rastet kur ai mund të marrë ndihmë shtetërore) për plotësimin e kushtit të pestë, që do të garantonin realizimin e shërbimit pranë autoritetit kontraktor. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit në zbatim të formulës së përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, nuk është paraqitur dokumentacion provues që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të dorëzimit në mënyrë të detajuar të anës ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, metodës së përzgjedhur apo zgjidhjeve teknike të posaçme), duke mos krijuar bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Rrjedhimisht, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” SHPK, nuk është paraqitur argumentimi i ofertës anomalisht të ulët, në përputhje me nenin 93, pika 2, të LPP-së, ndaj oferta e këtij operatori duhet të skualifikohet nga ana e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” SHPK, nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-88148-11-17-2023, me objekt “Blerje Kompjutera dhe Projektor”, me fond limit: 2,054,475.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.01.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastrë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

